



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 104, datë 23.05.2025

PËR
“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONI PËR
PROKURORIN KRESHNIK AJAZI”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë me pjesëmarrjen e:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
6. Ledina RIZA	Anëtar (në mungesë)
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar (në mungesë)
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 23.05.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e veprimtarisë jashtë funksioni për prokurorin Kreshnik Ajazi”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 1359 prot., datë 19.05.2025, të Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, dëgjoi relatorin z. Zeqir Hoda, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Brenda kompetencave ligjore dhe nënligjore, Këshilli shqyrton kërkesat e prokurorëve për veprimtari jashtë funksioni.
2. Pranë Këshillit është administruar me nr. 1322 prot., datë 12.05.2025, kërkesa e prokurorit Kreshnik Ajazi nr. 4852 prot., datë 09.05.2025, për veprimtari jashtë funksionit të prokurorit.
3. Prokurori në kërkesën e tij qartëson se, angazhimi i referohet përfshirjes si ekspert lokal në Programin JUFREX që realizohet nga Këshilli i Evropës me përmbajtje “Mbrotja e lirisë së Shprehjes dhe e medias në Shqipëri”. Angazhimi si bashkë-lektor do të realizohet në Shkodër dhe konsiston në trajtimin e prokurorëve dhe oficerëve të Policisë së Shtetit, në datë 25 qershor 2025.
4. Kërkuesi thekson se, rimbursimi financiar do të kryhet sipas normave të Këshillit të Evropës, kohëzgjatja në total është 1 (një) ditë pune dhe nuk cenon ushtrimin e funksioneve të prokurorit.
5. Kërkesa e prokurorit shoqërohet nga Vërtetimi datë 09.05.2025, i Zyrës së Regjistrimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në të cilin Këshilli njoftohet se:

*“Nga verifikimi i kryer nga Zyra e Regjistrimit, të dhënat e regjistrave elektronikë për vitet 2024-2025, numri i çështjeve penale në fazë hetimi dhe gjykimi është si vijon:
Për vitin 2024 numri i çështjeve penale nën hetim është 8(tetë) procedime penale dhe ai në fazë gjykimi është 10(dhjetë) procedime penale.
Për vitin 2025 numri i çështjeve penale nën hetim është 15 (pesëmbëdhjetë) procedime penale dhe ai në fazë gjykimi është 1(një) procedim penal.”*

6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se, prokurori Kreshnik Ajazi nuk është subjekt i ndonjë procedimi disiplinor dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi.
7. Ushtrimi i veprimtarisë jashtë funksionit në masën dhe kohën e kërkuar vlerësohet nga Këshilli se, nuk ndikon negativisht në ushtrimin e detyrës së tij, si dhe:

- është në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;

- 
- nuk është e papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe nuk ndalohet sipas ligjit.
 - nuk krijon perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;
 - nuk bie ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë efikase të funksioneve.

8. Këshilli vlerëson se, kërkesa e prokurorit Kreshnik Ajazi për të ushtruar veprimtari jashtë funksioni sipas objektit të saj përmbush kriteret ligjore.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149/a, germa “e”, 149/ç, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 157, 164, dhe 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe Rregulloren “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Kreshnik Ajazi si ekspert lokal/ trajnues i Programit JUFREX të Këshillit të Evropës, në trajnimin me përmbajtje “*Mbrojtja e lirisë së Shprehjes dhe e medias në Shqipëri*”, që realizohet në Shkodër, në datë 25 Qershor 2025.
2. Ky vendim i njoftohet prokurorit Kreshnik Ajazi dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 23.05.2025.

KRYETAR

Mirela Bogdani

